

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Papa Leo XIV i bën thirrje Kishës franceze të vazhdojë luftën kundër abuzimit seksual
ADRESA	https://kohajone.com/aktualitet/papa-leo-xiv-i-ben-thirrje-kishes-franceze-te-vazhdoje-luften-kunder-abuzimit-seksual/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 17:49:40 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 17:46:12 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f9a6a44ac38c77436697a95e653401493ad4c5126dda2ac52ed5cf3d796521c4
TEKSTI	7121088fe5c85914953506265e726e2aff98bf5e8d5f9517bed4163a6134ac5e
PAMJA	847ad51c02902a6a2cd962a54f17c25e0d760a7d7a0fdca84f948a9075d71fd5

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ea8702e658d266a83800680e5e64f4205772c52950c4f165333ed660d9a61437
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b1c7a27947b4cc546e59bf39e541eaf49f294f8d53ee0afce777d7f589624631
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ea8702e658d266a83800680e5e64f4205772c52950c4f165333ed660d9a61437>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Papa Leo XIV i bën thirrje Kishës franceze të vazhdojë luftën kundër abuzimit seksual

AKTUALITET BOTA E DIEL, 27 SHTATOR 2026 19:46



Papa Leo XIV i ka bërë thirrje Kishës Katolike në Francë të pranojë përgjegjësinë për dështimet e saj dhe të vazhdojë luftën kundër abuzimeve seksuale, gjatë vizitës së tij në Lourdes.

Duke celebruar të dielën një meshë në ambient të hapur në shenjtëroren e Lourdes, ku u mbledhën rreth 150 mijë besimtarë, Papa u përqendrua te nevoja që Kisha të përballet me plagët e shkaktuara nga abuzimet dhe të mos shmangë përgjegjësinë për veprimet e kryera brenda saj.



KOHJA JONË

Na ndiqni në YouTube



SUBSCRIBE

"Kisha duhet të ketë guxim të jetë e para që ta kalojë këtë kthesë", tha Leo XIV, duke theksuar se për shërimin e plagëve të thella dhe gabimeve të kryera brenda institucionit nevojitet përlësi dhe gatishmëri për ndryshim.

Ai shtoi se pranimi i gabimeve është një hap i domosdoshëm për përparimin shpirtëror dhe për rindërtimin e besimit, transmeton Telegrafi.

Më herët gjatë së dielës, Papa u takua privatisht me peshkopët francezë dhe vlerësoi masat që ata kanë ndërmarrë për përballimin e abuzimeve seksuale ndaj të miturve. Ai i inkurajoi që të vazhdojnë këtë rrugë me "vigjilencën më të madhe", duke e lidhur luftën kundër abuzimeve me drejtësinë, dëgjimin e viktimave, riparimin dhe parandalimin.

"Ju keni marrë masa të guximshme për t'iu përgjigjur kësaj plaje, përmes dëgjimit, kërkimit të së vërtetës, drejtësisë, faljes, dëmshpërblimit dhe një angazhimi të vendosur për një kulturë parandalimi dhe mbrojtjeje", u tha Papa peshkopëve.

Leo XIV pritej gjithashtu të takojë privatisht me shtatë persona që kanë mbijetuar abuzime seksuale të kryera nga pjesëtarë të klerit, një takim që është pjesë e rëndësishme e vizitës së tij në Lourdes. Mes tyre është edhe një person që ka deklaruar se është abuzuar në moshë madhore.

Takimi është shoqëruar megjithatë me kritika nga disa organizata të viktimave, të cilat kanë vënë në pikëpyetje mënyrën e përzgjedhjes së shtatë pjesëmarrësve. Disa të mbijetuar kanë kërkuar që Kisha të mos ketë rolin kryesor në përcaktimin e personave që do të takohen me Papën.

Zëdhënësi i Konferencës së Peshkopëve të Francës, monsinjor Pierre-Antoine Bozo, ka shpjeguar se dy prej shtatë pjesëmarrësve janë propozuar nga organizata të viktimave. Sipas tij, Papa ka zgjedhur një grup të vogël për të krijuar

LAJMET KRYESORE



Mesazh urgjent i kryeministrit Rama sapo mbërriti nga SHBA (fjala e plotë)



A do të shkojë ambasadori Wendt në Selinë Blu për të takuar Berishën?



Shqipëria fiton me dy gola ndaj Bjellorusisë



Mirë se vjen, Ambasador Wendt!



Presidenti Begaj zbardh takimin me ambasadorin e ri të SHBA, Eric Wendt

TË PËRZGJEDHURA



Singapori paguan qytetarët për të lexuar: 15 minuta në ditë në këmbim të parave



David Beckham merr 39 milionë paund dividend, marrëveshjet e Kupës së Botës nxisin fitime rekord



Ish-ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu te Nikoll Lesi: Nuk ka ministra hije! Balluku-lokomotivë shtetfo...



Sukses i menjëhershëm për Muse të Metës: Mjeti i AI tejkalon rivalët si ChatGPT dhe Claude



Inteligjenca artificiale mund të jetë më e rrezikshme se bomba atomike. Robotët e vitëve 2030, 2040, 2...

MË TË LEXUARAT

mundësinë e një bisede më personale dhe më të drejtpërdrejtë.

Kjo çështje mbetet veçanërisht e ndjeshme në Francë pas publikimit në vitin 2021 të raportit të Komisionit Sauvé, i cili vlerësoi se rreth 330 mijë fëmijë ishin abuzuar seksualisht gjatë një periudhe rreth 70-vjeçare nga priftërinj, punonjës të Kishës dhe persona të lidhur me institucionet katolike. Raporti identifikoi gjithashtu rreth 3 mijë autorë të dyshuar mes klerit dhe punonjësve të institucioneve kishtare.

Në përgjigje të kësaj krize, Kisha franceze ka krijuar një mekanizëm të pavarur për njohjen dhe dëmshpërblimin e viktimave. Sipas të dhënave të fundit, rreth 2 mijë persona kanë kërkuar dëmshpërblim përmes këtij sistemi, ndërsa më shumë se një mijë vendime për kompensim janë finalizuar.

Vizita e Papës në Lourdes vjen në ditën e tretë të qëndrimit të tij në Francë dhe është një nga momentet më të rëndësishme të udhëtimit, jo vetëm për shkak të numrit të madh të besimtarëve, por edhe për shkak të fokusit të veçantë te plagët që abuzimet seksuale kanë lënë brenda Kishës franceze.

Për Leo XIV, takimi me viktimat dhe mesazhi drejtuar peshkopëve synojnë të theksojnë nevojën për përgjegjësi, mbrojtje më të fortë të të miturve dhe vazhdimin e reformave për parandalimin e abuzimeve. /Telegrafi/

MË SHUMË NGA AKTUALITETI



Aktivisti Arben Kola ditën e 120-të të protestës, ka hedhur akuza të ...



Orteku godet Himlung Himal, të paktën 10 të zhdukur, moti i keq pengo...



Noizy bëhet 40-vjeç, Loredana dhe Blerim Destani shkaktojnë të qeshur...



Dita e 120-të e reagimit qytetare ndaj keqqeverisjes, protestuesit pë...



Delet "milionëshe": Raca e re gjigante e deleve që po bën bujë në Kir...



Nëntë të arrestuar për krime lufte në Zubin Potok lidhur me rastin e ...

LAJMET E FUNDIT



Papa Leo XIV i bën thirrje Kishës franceze të vazhdojë luftën kundër abuzimit seksual

[3 MINUTA MË PARË](#)



Aktivisti Arben Kola ditën e 120-të të protestës, ka hedhur akuza të forta ndaj kryeministrit Edi Rama dhe qeverisë

[13 MINUTA MË PARË](#)



Orteku godet Himlung Himal, të paktën 10 të zhdukur, moti i keq pengon operacionet e shpëtimit

[29 MINUTA MË PARË](#)



Noizy bëhet 40-vjeç, Loredana



Dita e 120-të e reagimit qytetare



Delet "milionëshe": Raca e re

one bierim Vestani shkaktonte
të qeshura me befasinë për
ditëlindje

32 MINUTA MË PARË

ndaj keqqeverisjes,
protestuesit përsërisin
kërkesën e largimit të Ramës

35 MINUTA MË PARË

gjigante e oelëve që po den
bujë në Kirgizi

43 MINUTA MË PARË

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >

KOHA JONË

Gazeta "KOHA JONË" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991

Botues: Nikoll LESI. Adresa e redaksisë: Rruga "Samë Frasheri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

TË FUNDIT

LAJME

SPORTI

EKONOMI

EDITORIAL

WEBTV

AKTUALITET

RAJONI

KOSOVA

BOTA

TEKNOLOGJI

SHOWBIZ

SHËNDETI

SOCIALE

TURIZËM

KURIOZITETE

KULTURA

HISTORIKU

KONTAKT

BOTUES & DREJTOR: Nikoll LESI

KRYEREDAKTOR: Daniel MUÇAKU

ZV/KRYEREDAKTOR: Redjon SHYLLA

BORDI: Elsa KAMBERI, KRYETARE

NIPT: J71425013C



NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA

SD

© 2024 KOHA JONË. All rights reserved.

PRIVACY POLICY

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.